BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

Zbulimi i turizmit rural në Tiranë

Raport përmbledhës i sondazhit

Shtator 2020

Përmbajtja e tabelave

Faqe

Grafiku 1. Demografia 5

Grafiku 2. A janë të informuar qytetarët rreth atraksioneve dhe zonave turistike rurale 6

Grafiku 3. Si janë informuar rreth tyre 6

Grafiku 4. Cilat janë atraksionet/zonat më të vizituara 7

Grafiku 5. Çfarë aktivitete preferohen gjatë kohës që vizitojnë këto zona turistike 8

Grafiku 6. Vlerësimi për infrastrukturën rrugore 9

Grafiku 7. Vlerësimi për tabelat informuese 9

Grafiku 8. Vlerësimi për pastërtinë dhe mirëmbajtjen 10

Grafiku 9. Vlerësimi për destinacionet e agroturizmit 10

Grafiku 10. Vlerësimi për rrugicat dhe shtigjet e gjelbërta 11

Grafiku 11. Vlerësimi për festat dhe panairet lokale 11

Grafiku 12. Vlerësimi për produktet vendase 12

Grafiku 13. Vlerësimi për kontributin e Bashkisë së Tiranës 12

Grafiku 14. A do t'i rekomandonin qytetarët atraksionet e vizituara 13

Hyrje

Turizmi rural në shumë përkufizime i referohet udhëtimeve ku motivi kryesor është të shijosh zonat, komunitetet dhe përvojat rurale.

Tirana rurale përbëhet nga 13 Njësi Administrative (Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri), 135 fshatra, është një zonë e pasur me burime ujore ku përmendim lumenjtë Erzen, lumi i Tiranës dhe lumi Tërkuzë, ka një numër të konsiderueshëm liqenesh artificiale, si dhe gjendet parku kombëtar i Dajtit.

Një nga ambicjet e Bashkisë Tiranë (BT) është kthimi i turizmit rural në një element të rëndësishme të ekonomisë së Tiranës, duke shtuar 'menunë' me pika turistike, ndërtim rrugësh të reja drejt fshatrave të thellë, kanalizime e rrjete elektrike si dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor ekzistues. Elementë të tillë, si dhe faktorët klimaterik i kanë dhënë nje rritje të vazhdueshme turizmit rural këto vitet e fundit dhe kanë frenuar shpërnguljen e popullsisë rurale.

Tirana ka mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit ndër të cilat veçojmë:

-*Turizmi kulturor* si një nga tipologjitë turistike më të vlerësuara dhe të kërkuara tashmë në tregun botëror. Qyteti ka një numër të konsiderueshëm monumentesh kulturore si: kalaja e Tiranës, mozaiku i Tiranës, kalaja e Dajtit, kalaja e Tujanit, ura e Brarit, kalaja e Ndroqit, kalaja e Dorzit, kalaja e Petrelës, etj.

-*Turizmi i aventurës*, me krijimin e shtigjeve turistike, infrastrukturës për hiking e biking. Shtigjet për hiking në shumicën e rasteve ndjekin rrugët e vjetra në zonat rurale për të nxjerrë drejt atraksioneve natyrore dhe atyre kulturore.

-*Agroturizmi dhe turizmi kulinar* lidhet me shijimin e ushqimeve karakteristike krahinore që ndërthuret me peizazhin e mrekullueshëm rural e ajrin e pastër. Vëmendje e madhe i është kushtuar zhvillimit rural duke nxitur dhe mbështetur fermerët për prodhimin e produkteve "made in Tirana".

Bashkia Tiranë ka investuar kohët e fundit në vendosjen e tabelave informuese dhe orientuese në zonat kryesore turistike të qytetit, vendosjen e tabelave flamur në çdo NJA, si dhe ka pajisur me tabela dhe harta turistike hyrëse 5 njësi administrative rurale (Petrela, Baldushku, Peza, Ndroqi dhe Vaqarr).

Duke patur parasysh se numri i turistëve në Tiranë po rritet ndjeshëm çdo vit, është shumë e rëndësishme që asetet kulturore e natyrore të Tiranës të promovohen vazhdimisht.

Qëllimi dhe objektivat e sondazhit

Qëllimi i këtij sondazhi është evidentimi i opinionit qytetar mbi informacionin që kanë rreth atraksioneve dhe zonave turistike rurale përreth Tiranës, shpeshtësinë e frekuentimit, mundësitë e argëtimit që këto destinacione ofrojnë dhe kushtet në të cilat janë.

Ky sondazh synon të nxjerrë në pah:

1. Nivelin e informimit të qytetarëve rreth atraksioneve në zonat turistike rurale, mënyrën e informimit rreth tyre, si dhe cilat janë atraksionet më të vizituara;
2. Aktivitetet që preferojnë të kryejnë gjatë vizitave në këto zona;
3. Vlerësimin e turizmit rural sipas elementeve: infrastruktura rrugore, tabelat informuese, pastërtia dhe mirëmbajtja, destinacionet e agroturizmit, rrugicat dhe shtigjet e gjelbërta, festat dhe panairet lokale, produktet vendase;
4. Vlerësimin mbi kontributin që jep Bashkia Tiranë për zhvillimin ekonomik në zonat rurale, nëpërmjet promovimit të atraksioneve, agroturizmit dhe produkteve tradicionale rurale, për ngritjen e tregjeve sezonale, panaireve dhe organizimin e festave lokale, përmirësimin e potencialit turistik etj;
5. Sugjerimet e të anketuarve mbi mënyrën se si mund të promovohet dhe zhvillohet më tepër turizmi rural;
6. Rekomandimin nga qytetarët të këtyre destinacioneve tek persona të tjerë.

REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT

Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total e të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së mendimit qytetar.

Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:

Të dhëna mbi demografinë (700 të anketuar)

Grafiku 1. Demografia

a. Gjinia



b. Grup-mosha (vjeç)



Grafiku 2. A janë të informuar qytetarët rreth atraksioneve dhe zonave turistike rurale



Grafiku 3. Si janë informuar rreth tyre[1]



[1]Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë, i paraqitur në këtë pyetje, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të zgjedhur më shumë se një alternativë brenda të njëjtës pyetje.

Grafiku 4. Cilat janë atraksionet/zonat më të vizituara[2]



[2]Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë, i paraqitur në këtë pyetje, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të zgjedhur më shumë se një alternativë brenda të njëjtës pyetje.

Grafiku 5. Çfarë aktivitete preferohen gjatë kohës që vizitojnë këto zona turistike[3]



[3]Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë, i paraqitur në këtë pyetje, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të zgjedhur më shumë se një alternativë brenda të njëjtës pyetje.

Vlerësimi i zonave turistike rurale sipas elementëve

Grafiku 6. Vlerësimi për infrastrukturën rrugore



Grafiku 7. Vlerësimi për tabelat informuese



Grafiku 8. Vlerësimi për pastërtinë dhe mirëmbajtjen



Grafiku 9. Vlerësimi për destinacionet e agroturizmit



Grafiku 10. Vlerësimi për rrugicat dhe shtigjet e gjelbërta



Grafiku 11. Vlerësimi për festat dhe panairet lokale



Grafiku 12. Vlerësimi për produktet vendase



Grafiku 13. Vlerësimi për kontributin e Bashkisë së Tiranës në promovimin e turizmit rural[4]



[4] Vlerësim nga 1 - 10, ku 1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë

Grafiku 14. A do t'i rekomandonin qytetarët atraksionet e vizituara tek të tjerët



Çfarë mendojnë qytetarët se mund të ndihmojë në promovimin dhe zhvillimin e turizmit rural në Tiranë:

- *realizimi i më shumë fushatave reklamuese;*
- *mbajta pastër e ambjenteve;*
- *sistemimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore;*
- *organizimi i me shumë panaireve, festave tradicionale, si dhe reklamimi i tyre nëpër media dhe rrjete sociale;*
- *transmetimi i dokumentarëve informues në media;*
- *më shumë investime nga bashkia;*
- *përkrahje më e madhe nga ana e bashkisë;*
- *ndërgjegjësim njerëzor dhe mirëmbajtje;*
- *infrastrukturë më e mirë, më shumë promovim, ndoshta linjë urbane për disa nga destinacionet;*
- *pastrimi më i shpeshtë i zonave nga bimësia e egër, për lirimin dhe krijimin e shtigjeve të gjelbërta;*
- *përcaktimi i zonave barbeky, vendosja e koshave të mbeturinave dhe tualeteve;*
- *ndërtimi i zonave për sportet e aventurës, të relaksit dhe të argëtimit;*
- *organizimi i më shumë aktiviteteve promovuese prë disa destinacione;*
- *sigurimi i transportit ekonomik;*
- *infrastrukturë lidhëse që lehtëson aksesin në destinacione;*
- *futja si lëndë në kurikulat mësimore në shkollat 9-vjeçare;*
- *informacion më iplotë për destinacionet;*
- *realizimi i një botimi nga BT për atraksionet;*
- *përgatitja e broshurave për atraksionet;*
- *vendosja e tabelave më të qarta dalluese për shtigjet dhe monopatet.*

ANEKS 1 – PYETËSORI I SONDAZHIT

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

PYETËSOR MBI TURIZMIN RURAL NË TIRANË

Nr. i pyetësorit_____ Tiranë, më _____/_____2020

SEKSIONI I: Të dhëna demografike

Nj.A / Lagje	Gjinia		Grup-mosha				
	F	**M**	**Nën 18**	**19-35**	**36-50**	**51-65**	**Mbi 65**

SEKSIONI II: Pyetje

1. A jeni të informuar mbi atraksionet dhe zonat turistike rurale përreth Tiranës?

☐ Po ☐ Jo

a) Nëse **PO,** si jeni informuar rreth tyre?

☐ Media ☐ Faqja zyrtare e BT ☐ Rrjete sociale ☐ Operatorë turistikë ☐ Sugjeruar (miq, familjarë etj)

2. Cilën/at nga këto atraksione keni vizituar?
(Mund të përzgjidhni më shumë se një)

	Liqeni i Farkës		Parku i Pezës
	Liqeni i Kasharit		Kalaja e Petrelës
	Liqeni i Bovillës		Kalaja e Ndroqit
	Liqeni i fshatit Prush		Kanioni i shkallës së Tujanit
	Liqeni i Vaqarrit		Kanioni i Lumit Tërkuzë
	Liqeni Pezë Helmes		Kanioni i Shmokut, Priskë e madhe
	Syri i Cikllopit në Krrabë		Parku i Baldushkt
	Ujëvara e Shën Gjergjit		Shpella e Pëllumbasit
	Ujëvara e Besh Livadhit		Shpella e Mbytjes, Krrabë
	Ujëvara e Përroit të Murdharit		Shpella e Zojës, fshati Brrar
	Ujëvara e Kakunjës		Shpella e Mirë-tur ose ndryshe shpella e Shëngjergjit
	Parku i malit të Dajtit		Shpella e Valit
Tjetër:			

3. Çfarë aktivitete preferoni të kryeni gjatë kohës që vizitoni këto atraksione?

- ☐ Ecje në natyrë
- ☐ Sporte të ndryshme
- ☐ Njohja me traditat dhe historinë
- ☐ Piknik
- ☐ Blerja e produkteve vendase
- ☐ Kulinari dhe edukim agrokulturor
- ☐ Kamping
- ☐ Tjetër_____

4. Vlerësoni zonat turistike rurale përreth Tiranës sipas elementëve të mëposhtëm:

Nr		Aspak mirë	Jo mirë	Mesatarisht	Mirë	Shumë mirë	Pa përgjigje
1	Infrastruktura rrugore						
2	Tabelat informuese						
3	Pastërtia dhe mirëmbajtja						
4	Destinacionet e agroturizmit						
5	Rrugicat dhe shtigjet e gjelbërta						
6	Festat dhe panairet lokale						
7	Produktet vendase						
	Tjetër:						

5. Si e vlerësoni kontributin që jep Bashkia Tiranë për zhvillimin ekonomik në zonat rurale, nëpërmjet promovimit të atraksioneve të agroturizmit dhe produkteve tradicionale vendase, ngritja e tregjeve sezonale, panaire dhe festa lokale, përmirësimi i infrastrukturës etj.

Aspak e mirë – 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 – Shumë e mirë

6. Çfarë mendoni se mund të ndihmojë në promovimin dhe zhvillimin e turizmit rural në Tiranë?

_____

7. A do t'i rekomandonit atraksionet turistike rurale të Tiranës tek persona të tjerë?

☐ Po ☐ Jo ☐ Pa përgjigje

Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim vjeljen e opinionit qytetatar mbi turizmin në zonat rurale përreth Tiranës. Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".
Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.

ANEKS 2 – LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR

1. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Ligji nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, miratuar në datën 18.9.2014.
3. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
4. Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"”.
5. përditësuar).
6. Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
7. Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.